

Nr.regj:37293/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Valdrin Uka, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 par.1 i sanksionuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 73.74 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 07.12.2011 merr këtë:

## AKT VENDIM

I PANDEHURI: Valdrin Masar Uka, i lindur me 28.12.1980 në Gjakovë, me vendbanim ne Fushe Kosove, l."Dardania "A 20 hy.1 nr.34, i martuar, ka të kryer fakultetin, Kryeshef ne Agjensionin per Promovimin e Investimeve ne Ministrine e Tregtise dhe Industrise, dhe jeton ne gjendje te mesme ekonomike.

## Eshte pergjegjes

Sepse si zyrtarë e larte ne Ministrine e Tregtise dhe Industrise te Republikes se Kosoves-Kryeshef ne Agjensionin per Promovimin e Investimeve, nuk e ka bere deklarimin e pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit, me rastin e marrjes se detyres, ne afatin e parapare ligjor.

Me veprim te ketille ka kryer kundervajtje nga neni 7 par 1 i sanksionuar me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, andaj per kete,

## GJOBITET

Me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e te hyrave te KGJK-se, No.1000 4300 7000 0518. Pagesa behet ne ndonjeren agjensi per mbledhjen e te hyrave -banke, permes urdherpageses te plotesuar nga gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime te procedures nuk ka patur, kurse ne emer te paushallit gjyqesor i pandehuri eshte i obliguar te paguaje shumen prej 5(pese) €, ne sherbimin e arkes se gjykates. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

## Arsyetim

Agjensia Kunder Korrupsionit, Prishtine parashtrroi kërkesen me nr.01/4095/11 më dt. 26.10.2011 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Ne baze te kerkeses se parashtruar u inicua procedura kundervajtese me marrjen ne pyetje te pandehurin, i cili deklaroi se, ne poziten e kryeshefit te Agjensionit per Promovimin e Investimeve eshte emeruar me vendim te kryeministrit te dates 27.07.2011, ndersa ka filluar punen me date 11.08.2011. Me tutje shton se me date 06.09.2011 ka pranuar nje mesazh permes postes elektronike nga udheheqesja e Divizionit te Personelit, me te cilin eshte njoftuar per obligimin e deklarimit te pasurise prane Agjensionit Kunder

AGJENSIA KUNDER KORRUPSIONIT ANTICORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK / DMP	03-1727/2012
No. i laq. 02	Data 11.05.2012
Pro, stranca	
No. i pasq.	

Korrupsionit, mirpo edhe perkunder kësaj i njëjti shton se per shkak te ngarkeses ne pune ,udhëtimeve jashte vendit nuk ka mundur qe obligimin e deklarimit te pasurise ta përmbush ne afatin e parapare ligjor,por nje obligim te tille e ka kryer me date 27.10.2011dhe njejherit kërkon nga gjykata qe ti kete parasysh keto rrethana me rastin e vendosjes..

Ne baze te te dhenave ne kerkese,deklarates se te pandehurit, shiqimit te shkresave te lendes dhe provave tjera te administruara gjate procedures, ne mase te mjaftuar u vertetua se i pandehuri e ka kryer kundervajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre,per çka u shpall pergjegjes dhe u denua me gjobe si ne dispozitiv te ketij aktvendimi .

Me rastin e shqiptimit te denimit ,konform nenit 7 te LMK,se ,u moren parasysh te gjitha rrethanat e kryerjes se kundervajtjes,dhe te pandehurit iu shqiptua denimi me gjobe ne lartesine si ne dispozitiv ,duke konsideruar se edhe me kete do te arrihet efekti i sanksionimit ,ashu qe i pandehuri ne te ardhmen tu shmanget kryerjes se veprave te tilla apo te ngjashme kundervajtese .

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrijë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës,Gjykates se Larte per Kundervajtje, në afatin prej 8 ditësh,pas marrjes se ketij aktvendimi,nepermes kesaj gjykate dhe pa taksa

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

Gjyqtarja  
Zajrete Muhaxheri

